



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA E PROKURIMIT
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve
mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mobilje- 39100000-3

Karrige-39112000-0

Vende, karrige dhe produkteve të përafërta, dhe pjesët e lidhura-39110000-6

Kolltuqe-39113100-8

Divanë- 39113200-9

Tavolina pune-39121100-7

Dollapë dhe rafte librash-39122000-3

Mobilje për zyra-39130000-2

Rafte për zyra-39131000-9

Dollapë organizimi dosjesh-39132100-7

Komodina-39143123-4

Mobilje të ndryshme- 39151000-5

Banakë-39171000-1

Perde-39515110-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

22,490,000 (njëzetë e dy million e katërqind e nëntëdhjetë mijë) **Lekë pa TVSH** ose 229,162.42 (dyqind e nëzetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy pik dyzetë e dy) **euro**. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 30.12.2024 është 98.14 lekë/euro.

E ndarë si më poshtë:

Fondit limit për Fakultetin e Mjekësisë është **14,950,000 (katërmëdhjetë million e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH** ose **152,333.40** (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e tre pik dyzetë) **euro** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 30.12.2024 është 98.14 lekë/euro.

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike vlera e fondit limit është **4,100,000 (katër milion e njëqind mijë) lekë pa TVSH ose 41,777.05** (dyzetë e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pik zero pesë) **euro** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 30.12.2024 është 98.14 lekë/euro.

Për Fakultetin e Mjekësisë Dentare vlera totale vlera e fondit limit është **940,000 (nëntëqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH ose 9,578.15** (nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë pik pesëmbëdhjetë) **euro** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 30.12.2024 është 98.14 lekë/euro.

Për Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë vlera e fondit limit është **2,500,000 (dy million e pesëqind mijë) lekë pa TVSH ose 25,473.81** (njëzetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre pik tetëdhjetë e një) **euro** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 30.12.2024 është 98.14 lekë/euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë.

DOKUMENTAT E TENDERIT:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2 I. KRITERET E VEÇANTA Ë KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të

kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar,

ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

***Shënim:** Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data

e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që

furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjykuar te arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE.

Percaktimi i vlerës së sipërcituar për furnizimet e mëparshme të ngjashme është një kriter i thjeshtësuar pranimi nga AK me qëllim nxitjen e pjesmarrjes dhe të Operatorëve të rinj në treg. Në këtë mënyrë AK krjon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 20 (njëzetë) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie bazuar në nenin të 77 pika 1 gërma c) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”. Punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin e mallrave apo ngjitjen e tyre në katet dhe godinat përkatëse në të gjitha Njësitë shpenzuese dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës.

Shenim: Kriteri nr.2.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën

1 (një) inxhinier druri vërtetuar me:

- a. kontratën individuale të punës;
- b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

1 (një) arkitekt vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

4 (kater) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me:

- a. kontratën individuale të punës;
- b. certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;

1 (një) Bojaxhi për prodhime druri vërtetuar me:

- a) kontratën individuale të punës;
- b) certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;

1 (një) shofer vërtetuar me:

- a. kontratën individuale të punës ose kontratë bashkëpunimi të vlefshme;
- b. leje drejtimi

2 (dy) punonjës për montim, asamblimin vërtetuar me:

- a. kontratën individuale të punës;

- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

***Shenim:** Kriteri nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

***Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Punonjësit me specialitet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Ngjyra e mobiljeve është një element që nuk është përfshirë në specifikimet teknike, pasi kjo do të përcaktohet nga Autoritet Kontraktore përfituese në momentin e realizimit, e cila do të jetë në varësi të preferencave të këtyre autoriteteve me qëllim përshtatjen e mobiljeve me amjentet ku do të vendosen. Argumentimi për stafin e kualifikuar të kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri.

- Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një inxhinier druri ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, për të siguruar që mobiljet janë të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një inxhinier druri ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier druri mund të mbykqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoritet Kontraktore përfituese në këtë procedurë prokurimi.

- 4 marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri:

marangozi/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri ka njohuritë e duhura në lidhje me përpuniminin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambiente publike, pasi montimi i gabuar i tyre mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Janë kërkuar **4 marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri pasi janë 4 Njësi Shpenzuese respektivisht;**

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- Universiteti i Mjekësisë Tiranë, (Rektorati)

Shpërndarja e 4 marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri do të bëhet në mënyrë të barabartë të të 4-ta Njësitë.

1(një) Bojaxhi/llustrues për prodhime druri

Një bojaxhi/llustrues i prodhimeve të drurit profesionist siguron që mobiljet të kenë një përfundim të lëmuar dhe të qëndrueshëm, gjë që përmirëson dukshëm pamjen estetike të mobiljeve dhe i bën ato të përshtatshme për përdoruesit përfundimtar, vecanërisht kur mobiljet janë pjesë e ambienteve publike. Përdorimi jo vetëm i bojës cilësore, por edhe aplikimi i duhur nga një specialist, rrit rezistencën e mobiljeve ndaj lagështisë, pluhurit, konsumimit apo faktorëve të tjerë të jashtëm dhe kjo bën të rritet qëndrueshmëria apo jetëgjatësia e tyre, duke ulur nevojën për riparime apo zëvendësime të shpeshta. Aplikimi i bojës nga një profesionist i kualifikuar ndihmon në shmangjen e defekteve si njollat, mbeturinat apo përhapje e pabarabartë e bojës, Bojaxhiu profesionist është i trajnuar për të zgjedhur bojërat që janë në përputhje me standartet e sigurisë dhe mjedisit, gjë që ndihmon në sigurimin e një mjedisi të sigurt për përdoruesit e tyre që janë punonjësit e Autoriteteve Kontraktore përfituese. Kërkesa për një bojaxhi druri profesionist është një tregues i standarteve të larta të cilësisë në produktin përfundimtar.

1 (një) arkitekt

Arkitekti është i domosdoshëm pasi ka aftësitë profesionale për të siguruar vendosjen e mallrave dhe pajisjeve për mobilim në hapsirat e duhura brenda Njërive shpenzuese si dhe është i domosdoshëm për

eliminim e gabimeve gjatë vendosjeve të pajisjeve dhe mobiljeve dhe menaxhimin e kohës në mënyrë eficiente që most ë ketë vonesa në realizimin e objektit të prokurimit në kohën e duhur. Arkitekti do të ofrojë

njohurit e tij profesionale dhe për përzgjedhjen e ngjyrave ,përdorimit në menyrën e duhur të hapsirave se si dhe ku do të vendosen mobiljet, organizimin e mobiljeve, materiale dhe objekteve të tjera në mënyrë që të krijohet një ambient funksional ,komod dhe i përshtatshëm me rëndësi të vecantë për salat e studentëve.

2 (dy) punonjës për montimin, asamblimin

Punonjësit për montin, asamblim janë të domosdoshëm për montimin e mobiljeve, aksesoreve të tyre mbajtës dhe fiksimit të tyre në mënyrë të përshtatshme që mos të shkaktojnë lehtësisht pasiguri në raste të mosfiksimit të tyre në mënyrën e duhur mund të shkaktojnë aksidente. Të dy punonjësit do të alternohen në të 4-ta njësitet shpenzuese.

1 (një) shofer

Shoferi është i domosdoshëm për transportin e gjithë mobiljeve, aksesoreve të tyre dhe cdo pajisje të tërë të kërkuar sipas zërave në Dokumentat Standarte të Tenderit.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet transporti me kapacitet mbajtës min 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatëse të qerave.

Shenim: Kriteri nr.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoritetet kontraktore përfituese. Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë duke marrë parasysh se një pjesë e mallit do të shpërndahet në vendndodhje të ndryshme. Kërkesa për minimumi dy mjete është vendosur në propozicion me sasinë e mallit që kërkohet dhe vendodhjen e Autoriteteve Kontraktore përfituese. Është kërkuar që kapaciteti mbajtës të jetë minimumi 3.5 ton, duke marrë parasysh llojin e mallrave që do të transportohen, peshën dhe përmasat që kanë, sidomos disa prej mobiljeve. Një mjet me kapacitet të tillë siguron që mallrat të transportohen të sigurt dhe pa dëmtime në vendndodhjet e kërkuara.

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 14001-2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 45001:2018“Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme) ose ekuivalent.

ISO 28001:2007 (e vlefshme), ose ekuivalente "Per Sistemin e menaxhimit te sigurise se zinxhirit Furnizues"

Argumentimi: *Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilen gjeje me percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjën mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.*

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

ISO 28001:2007 (e vlefshme), ose ekuivalente "Per Sistemin e menaxhimit te sigurise se zinxhirit Furnizues" është një standart ndërkombëtarë i cili zvogëlon rreziqet e sigurisë së kompanisë. Duke identifikuar rreziqet e sigurisë dhe marrjen e masave adekuate, gabimet dhe dëmtimet minimizohen. Një përfitim tjetër i rëndësishëm është përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga direktivat përkatëse, veçanërisht në tregtinë në vendet e Bashkimit Evropian. Sidomos në aktivitetet e transportit, shumë kërkesa janë në përputhje me këtë standard.

Aplikimi i standardit ISO 28001 gjithashtu tregon aftësinë e kompanive për të identifikuar dhe kontrolluar rreziqet e sigurisë ndaj autoriteteve doganore. Natyrisht, cilësia e produktit dhe shërbimit të kompanive rritet, ulet kostot dhe rritet produktiviteti i tyre.

2.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një ambient ku ushtron veprimtarinë, sipas objektit të prokurimit, prodhim ose shitje/ tregitim/ mobilje/ pajisje zyre, për të cilën duhet të paraqesë:

- Akt pronësie, kontratë qiraje apo përdorimi i regjistruar në QKB, si ambient ku ushtron aktivitetin.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Ky kriter vendoset në përputhje të plotë vlerën dhe sasinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe me afatin e lëvrimit të mallit. Kjo kërkesë mbështetet në disa faktorë kryesorë që sigurojnë cilësinë e produktit, kapacitetin për përmushjen e kontratës në kohë dhe përmbushjen e standardeve teknike. Një ambient i përshtatshëm për prodhimin ose tregtimin e mallrave objekt prokurimi, mundëson kapacitetin e nevojshëm për të prodhuar apo tregtuar në mënyrë të qëndrueshme, pa ndërprerje ose vonesa dhe sipas standardeve të kërkuara, gjë që ndihmon në realizimin në afatet e caktuara të kontratës. Një ambient i përshtatshëm për prodhimin dhe tregtimin e mobiljeve është i pajisur me infrastrukturën dhe masat e sigurisë, që garantojnë mirëqënien dhe sigurinë e punonjësve, që ndikon drejtpërdrejt në vazhdimësinë e prodhimit ose tregtimit, me qëllim realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit. Gjithashtu një ambient i përshtatshëm ndikon në kushtet e ruajtjes të mallit, të cilat ndikojnë në cilësinë e produkteve, pasi ekspozimi ndaj lagështirës, pluhurit ose temperaturave të papërshtatshme mund të dëmtojë mallrat objekt prokurimi dhe të ulë jetëgjatësinë e tyre.*

2.7 Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim/leje mjedisore e tipit C për ushtrimin e aktivitetit përkatës kur ofertuesi është prodhues. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë secili duhet të disponojë autorizimin/lejen mjedisore

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktore zotërojnë licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore si dhe bazuar në Ligjin nr.10 081/ 2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH, i ndryshuar

3.Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër: 1 (një) vit garanci nga momenti i furnizimit për mallrat objekt i prokurimit në momentin së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi ose të cilësia të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.*

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklarohet se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Aautoriteteve Kontraktore përfitues.*

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë dorëzimin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfitues.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar dhe transportuar mallrat, deri në ambjentet e Aautoriteteve Kontraktore përfitues.*

Argumentim i Specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara nga Organi Qendror Blerës, të publikuara në faqen zyrtare të Operatorit Blerjeve të Përqëndruara www.obp.al, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe bazuar në kërkesat e Autoritetit Kontraktor sipas shkresës së Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë me nr. 4011 prot, datë 21.11.2024 protokolluar në UMT me Nr. 25/ Prot, datë 17.10.2023, shkresës së Fakultetit të Mjekësisë Dentare nr. 369 prot., datë 11.06.2024 protokolluar në UMT me Nr. 25/35 Prot., datë 11.06.2024 shkresës së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, për « të dërguara në formë shkresore, Katalogut të Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara Sha me objekt «Blerje orendish dhe paisjesh për mobilim»

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Tabela:

Nr.	Emërtimi	Specifikimet teknike	Njësi	Sasi
1	FAKULTETI MJEKËSISË	FAKULTETI MJEKËSISË		
	Tavolinë drejtuesi në formë L-je e 180x150 cmx 75 h cm	Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me material melamine trashësi 18 mm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementeve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolina e punës në pjesën e brendshme ka të montuar në njërin krah një bllok sirtarësh ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Ngjyra do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontrates nga AK-ja.	Copë	1
	Raft për dosje me material MDF 115x45x210 h cm	Raft për dosje, material MDF Raftet do të realizohen me MDF, ku në pjesën e jashtme ajo do të jetë të veshur me rimeso anigre si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me ngjyrë natyrale. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 18 mm, me rimeso anigre dhe kjo do të jetë e lyer ngjyrë natyrale. Duhet të kihet kujdes në montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit. Në pjesën e poshtme do të vendosen tapa fundore në mënyrë që të ketë një distancë të vogël nga dollapi me dyshemenë. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fibër 4 mm. Kanatat prej xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm. Xhami do jetë transparent me trashësi 4 mm. Permasat 115x45x 210 h cm .Ngjyra do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontrates nga AK-ja.	Copë	1
	Karrige pritje	Karriget të jenë statike me strukturë metalike, me seksion terthor tip tub oval 30x15 mm, me spesor $\delta = 1.5$ mm dhe lidheza metalike tubolare me diameter $\varnothing=18$ mm dhe trashësi $\delta=1.35$ mm që bashkojnë kembet. Ndërsa struktura e shpines të jete e kurbuar me kendin jo me të madh se 105 grad, në mënyrë që të formojnë një qendrim ergonomik ulëses dhe mbështetëses. Struktura metalike të lyhet me boje elektrostatische në temperaturën 220 grade, me ngjyrë të zeze. Fundi i kembëve dhe anësoret e tyre të mbulojnë me tapa. Ndenjesja dhe shpina të jenë me struktura të qëndrueshme, të mbushur me sfungjer me densitet të lartë me trashësi 35 mm. Në pjesën e brendshme të jenë të veshura me tekstil ose lëkurë ekologjike, ndërsa në pjesën e jashtme mbulojnë me kapak plastik të së njëjtës formë. Ngjyra do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontrates nga AK-ja.	Copë	16
	Poltron rrotullues (drejtuesi)	Poltron rrotullues (drejtuesi) Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë. Me një mekanizëm që lejon fiksimin e pozicioneve të ndryshme të përshtatshme në ulje. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore. Të ketë përshtatëse piston me gaz për nivelimin e lartësisë. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik ose plastik me 5 degëzime në formë ylli dhe me rrota sferike në ekstremet e tyre.	Copë	1
	Tavolinë e madhe mbledhje	Syprina MDF, jo e shkëlqyeshme pa venaturë druri, me trashësi 4 cm, me permasa 295*110*75 cm me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Me 4 këmbë me permasa 8 cm* 8 cm si dhe të jenë me mekanizëm nivelues. Syprina të ketë panel lidhës të padukshëm që të shpërndajë peshën e suprinës. Lartësia totale e tavolinës të jetë 75 cm. Takimi në tokë me distanciatorë plastik për lagështirën. Bordet anësore të planit të punës të jenë të harkuara. Bashkimi i planit të punës me këmbët të bëhet në mënyrë të tillë, që t'i japë tavolinës pamje solide. Ngjyra do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës.	Copë	1

	Karrige studenti model amfiteatri me tavolete	Dimensionet te jene 44.5x43x31.5h cm. Materiali polipropilen.Me rezistence te larte ndaj rrezeve te diellit. Te kete nje strukture qe nuk shqeteson shpiner dhe kembet dhe te kete nje veçori ndenjese ortopedike. Pjesa e perparme e sediljes te jete e projektuar per te parandaluar grisjen e duarve. Ngjyra do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës.	Copë	80
	Foltore transparente	Dimensione 60x120 h cm. Material plexiglass transparent. Bazament metalik .	Copë	1
	Tavoline pedagogu 240x80x75 h cm	Syprina melaminë me trashësi 32 mm. Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Me përmasa 240x80x75 h cm. Ngjyra do të përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës.	Copë	1
